



04 Shtator 2023

Nr. Prot 78

Drejtuar: Znj. Delina Ibrahimaj
Ministre
Ministria e Financave dhe Ekonomisë
Tiranë

Objekti: Komentet e biznesit mbi Projektligjin *“Për sigurimin e detyrueshëm të banesave nga tërmetet”*

Në Regjistrin Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike është publikuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, projektligji *“Për sigurimin e detyrueshëm të banesave nga tërmetet”*, (“Projektligji”).

Dhoma Amerikane e Tregtisë në Shqipëri (në vijim referuar si “Dhoma”) në funksion të misionit të saj për të ndihmuar bizneset të punojnë në një klimë të qëndrueshme, nëpërmjet kësaj Letre, dëshiron të përcjellë komentet e anëtarëve të saj në lidhje me këtë projektligj. Grupi i ekspertëve në Dhomën Amerikane është munduar të listojë disa rekomandime mbi çështje që kanë nevojë për sqarim ose përmirësim.

Një nga problematikat kryesore që vërehen në këtë projektligj është **mungesa e efikasitetit në skemën e propozuar**. Konstatojmë se është i rëndësishëm të bëhet një studim përveç rekomandimeve që të sqarojë nevojën mbi bazën e të cilit rezulton që një skemë e tillë mund të realizohet. Referenca në modelet e Turqisë, Rumanisë dhe Filipineve si dhe rekomandimet nga organizatat e huaja nuk mund të jenë baza justifikuese dhe as të mjaftueshme për një projektakt të tillë. Studimi duhet të dalë nga konteksti lokal mbi rrezikun sizmik, nga kultura juridike dhe në mënyrë të veçantë nga kultura e sigurimeve si dhe kushteve ekonomike. Mungesa dhe mospjesëmarrja në skemat e sigurimit (vullnetar në këtë rast) vjen kryesisht nga burimet e kufizuara financiare. Gjithashtu duam të theksojmë se sigurimi i banesës është mbi të gjitha një opsion dhe e drejtë e pronarit duke qenë në interes të drejtpërdrejtë të tij. Në këtë aspekt nuk na duket e drejtë imponimi i një police të tillë.

Një çështje e rëndësishme që duhet të parashikojë ky projektligj është **rregullimi dhe normimi i shumës së sigurimit, primit për tu paguar dhe kushtet e policës së sigurimit**, çështje të cilat meritojnë vëmendje dhe kujdes të posaçëm për impaktin financiar që kanë, sidomos në një shoqëri ku mungon kultura e sigurimit. Rekomandimi ynë është që të ketë një orientim paraprak mbi këtë pjesë pa prituri daljen e Vendimit të Këshillit të Ministrave me hyrjen në fuqi të ligjit.



Nga ana tjetër, ky projektligj parashikon sigurimin vetëm nga tërmetet, dhe jo nga fatkeqësitë e tjera natyrore si zjarret apo përmbytjet. Gjithashtu projektligji siguron vetëm banesën dhe jo lëndimet dëmet indirekte që mund të shkaktohen nga katastrofat. **Pra sigurimi mbetet jo i plotë.**

Nga analiza që është bërë këtij projektligji duket sikur qëllimi i tij është që të lehtësojë buxhetin e shtetit nga kostot e pësura në rast tërmeti dhe t'i mbulojë këto kosto nëpërmjet një fondi që do të përbëhet nga kontributet e individëve/ pronarëve/ poseduesve të banesave. Nga ana tjetër shteti mbetet përgjegjës në lidhje me dëmet e shkaktuara nga pasaktësitë e lejeve të ndërtimit apo mosrespektimi i kriterëve teknike në ndërtim apo në mbikqyrje të punimeve të ndërtimit.

Produkti i sigurimit të pronës nga tërmeti shitet tashmë prej vitesh nga kompanitë e sigurimit privat që operojnë në vendin tonë. Këto kompani njohin produktin, riskun që ka, janë të shtrira në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, kanë staf të trajnuar me ekspertë të cilët ndjekin çdo rast sigurimi pronë nga afër dhe e informojnë mirë klientin. Në këtë projektligj propozohet që shitja e policave të sigurimit të bëhet nëpërmjet një agjenti të vetëm, që do të përzgjidhet me Vendim Qeverie. Një skemë e tillë do të linte jashtë skemës së tregtimit të policës shoqëritë private të licensuara të sigurimeve, të cilat nuk do të mund të vepronin as qoftë edhe si agjentë shitjeje ose trajtues të kërkesave për dëmshpërbim. **Pra ky projektligj nuk e përfshin në asnjë formë sektorin privat të sigurimeve. Nëse ky ligj miratohet në këtë formë, kjo do të rrezikonte t'i hiqte tregut privat të sigurimeve produktin kryesor të sigurimit vullnetar.**

Mendojme që do të ishte më e përshtatshme që praktikën e dëmeve dhe sigurimeve të bëhen nga kompanitë e sigurimit të cilat tashmë i kanë strukturat e ngritura. Gjithashtu shteti mund të krijojë një bashkëpunim me kompanitë lidhur me sigurimin e detyrueshëm nga tërmeti (njëlloj si me produktin e sigurimit të detyrueshëm të automjeteve TPL), p.sh.- pagesa për sigurimin e pronës mund të bëhet tek kompanitë e sigurimit, ose direkt në llogarinë e shtetit nëpërmjet kompanive të sigurimit dhe me këtë rast klient mund të përfitojë edhe nga mbulime shtesë përveç tërmetit, si zjarri, përmbytja e t.j.. – Lindin natyrshëm disa pyetje : Pse është menduar që ky sigurim të bëhet nga sektori publik? Cila do të jetë ndërlidhja me sektorin privat të sigurimeve?

Kodi Civil në nenin 1145 përcakton se:

“Kur për të njëjtin rrezik sigurimi janë lidhur veçmas disa kontrata sigurimi në sigurues të ndryshëm, i siguruari duhet të njoftojë secilin sigurues, për të gjitha sigurimet.

Kur i siguruari me qëllim nuk jep njoftimin e sipërm, siguruesit nuk janë të detyruar të paguajnë shpërbimin e dëmit.

Kur vërtetohet ngjarja e sigurimit, i siguruari duhet të njoftojë të gjithë siguruesit, duke i treguar secilit emërtimin e të tjerëvesigurues.

I siguruari ka të drejtë të kërkojë nga secili sigurues shlyerjen e dëmit të detyruar sipas kontratës, por gjithsesi shumat e shlyera së bashku nuk duhet të kalojnë shumën e dëmit.”

Sa më sipër, rezulton se pagesa e primit të sigurimit në favor të bankave për financimin e blerjes dhe sigurimi i detyrueshëm sipas projektligjit mbivendosin njëra-tjetrën dhe



pavarësisht se pronari do të paguajë dy shuma primesh, ai mund të kompensohet vetëm për një vlerë të caktuar aq sa është shuma e dëmit. Në këto kushte duhet rregulluar që të mos detyrohet pronari të paguajë shuma primi për të cilat nuk ka përfitim. Pra, do të duhet që **pronat që janë siguruar në favor të bankave, apo me sigurim vullnetar pranë një shoqërie sigurimi, të mos jenë subjekt i sigurimit të detyrueshëm.**

Gjithashtu konstatojmë se për këtë projektligj procesi i konsultimit publik nuk është zhvilluar në përputhje me legjislacionin në fuqi (afati, mënyrat e njoftimit si dhe takimet e zhvilluara me grupet e interesit). **Nga dokumenti konsultativ rezulton se nuk ka pasur konsultime me tregun e sigurimeve, që e konsiderojmë të rëndësishme nisur edhe nga eksperiencia mbi tre dekada e këtyre kompanive në vlerësimin dhe tarifimin e rrezikut të tërmetit.**

Një tjetër paqartësi e projektligjit mbetet nëse Sigurimi do të kryhet nga një institucion shtetëror apo nëse do shteti do tja kalojë këto të drejta një subjekti privat (operator/agjent)? Nëse do i kalohet një subjekti privat duhet sqaruar mekanizmi nëpërmjet të cilit do të bëhet përzgjedhja dhe kontraktimi i këtyre subjekteve.

Gjithashtu në projektligj mungon parashikimi mbi bazën e cilit dokument do të vërtetohet pronësia në rastet e aplikimit të sigurimit mbi banesa që nuk janë të regjistruara në regjistrin kadastral.

Për më tepër është e pajustificuar në gjykimin tonë arsyeja e limitimit të përgjegjësisë për tërmete mbi 5 ballë kur ndërkohë dëmet mund të ndodhin edhe për goditje të një shkalle më të ulët për shkak të intensitetit dhe kohëzgjatjes së goditjes apo pasgoditjeve?

Me rëndësi në gjykimin tonë është gjithashtu që fryma e projektaktit e cila duhet të orientohet në incentiva për ata që zbatojnë ligjin dhe jo nga fryma ndëshkuese si mosaksesimi në e-albania etj të paktën për një periudhë të caktuar pas hyrjes në fuqi të ligjit.

Si më poshtë do të gjeni një përmbledhje të detajuar të neneve përkatëse për të cilat rekomandohen ndryshime:

Neni 1: Koment: së pari nga objekti i tij sigurimi i pronës është një vendim që vendoset nga vetë pronarët dhe nuk mund të vendoset me ligj. Së dyti, ligji parashikon sigurimin vetëm tërmetet, dhe jo ato të zjarreve apo përmytjeve. Ligji siguron vetëm banesën dhe jo lëndimet apo dëmet. Pra sigurimi nuk është i plotë.

Neni 3, pika 1/a. Koment: Përfshin vetëm banesa dhe njësi biznesi të pozicionuara në këto ndertesa (dyqanet e kateve të para psh). Nënkuptoheq që përjashtohen objektet industriale, punishte, magazinë etj. Nuk është e qartë nëse përfshihen apo jo hotelet apo të ngjashme Pra duhet të specifikohen më qartë cilat janë objektet që përfshihen dhe cilat përjashtohen referuar përdorimit dhe jo vetëm i materialeve me të cilat janë ndërtuar. Gjithashtu duhet sqaruar se cilat banesa duhet të sigurohen nga tërmeti, Banesa që kane çertifikatën e pronësisë apo dhe banesa të tjera të palegalizuara ende? Këto duhet të sigurohen nga pronari i objektit dhe jo nga qeramarrësi, pra duhet të jetë



detyrim i qeradhënësit. Nga hyrja në fuqi për kontratat e qerasë si do të veprohet me qeradhenësit?

Neni 4/a. Koment: “Subjekti që ka detyrimin për të paguar primin”- individ, person fizikë ose juridik, vendas apo të huaj, pronarë ose përdorues të pasurive të paluajtshme në territorin e Republikës së Shqipërisë....” Pronari është i qartë pasi përcaktohet me dokument hipotekor pronësie. Përdoruesi është i paqartë se cili quhet dhe përse ka detyrim të paguajë ai këtë sigurim dhe jo pronari. Mund të quhet përdorues në rastin kur prona nuk është rregjistruar akoma në hipotekë dhe nuk është pajisur akoma dokument pronësie? Qeramarrësi në gjykimin tonë nuk ka pse paguan. Rasti i qeramarrësit duhet përcaktuar më qartë ose duhet përjashtuar.

Duhet sqaruar në rastin e qeradhënies se duhet ta paguajë ai që ka titullin e pronësisë. Edhe termi “përdorues” nuk është i saktë sepse mund të jetë qeramarrës, mund të jetë blerësi që ka blerë pronën por e shfrytëzon pa e pasur në pronësi ende etj. **Ndërkohë termat sipërmarrës, investitorë janë përjashtuar fare.**

Neni 4/b.: “Sigurim i detyrueshëm i banesave nga tërmetet”: nënkupton subjekti” **Koment:** Si përkufizim nuk është i saktë sepse sigurimi nuk mund të nënkuptojë subjektin, duhet saktësuar.

Neni 4/c. Koment: Si do të veprohet në rastin e ndërtimeve të cilat nuk janë pajisur ende me çertifikata pronësie?

Neni 4/f Koment: Përkufizimi në pikën e) nënkupton tërmete me magnitudë duke filluar nga 5.0 ballë. Po nëse një tërmet më i vogël shkakton dëme në banesë a do jetë subjekt i rimbursimit pronari? Pse duhet të ketë kufizime për sa kohë që pronari është i detyruar të paguajë sigurim privat dhe nuk do të kompensohet në rast dëmtimi?

Paragrafi “Vlerësohen pjesë e ngjarjes së tërmetit, të gjitha tërmetet pasuese (paslëkundjet – aftershocks) si dhe zjarri, shpërthimi, rrëshqitjet e tokës apo ulje (zhvendosje) të shkaktuar nga lëkundjet pasuese, që ndodhin gjatë një periudhe kohore prej 72 (shtatëdhjetë e dy) orësh nga zhvillimi i ngjarjes së tërmetit” **Koment:** Po nëse këto fenomene ndodhin si pasojë e lëkundjes kryesore merren në konsideratë? Kjo duhet përcaktuar qartë.

Neni 4/h Koment: Zhvendosjet e tokës ndodhin edhe në planin horizontal. Nuk ka kuptim t’i bëhet referencë vetëm zhvendosjeve vertikale.

Neni 4/l Koment: Të jepet përkufizimi i “Fondit Kombëtar për Sigurimin e Detyrueshëm nga Tërmetet”. Mungon ky përkufizim.

Neni 4/m Koment: Ka një mbivendosje të pjesshme mes këtij sigurimi (polica e sigurimit të detyrueshëm) dhe sigurimit të përgjegjësisë në ndërtim (me afat 10 vjeçar) për ndërtimet e reja. Si është vlerësuar të veprohet në të tilla raste?

Neni 5. Koment: Po në rastin e sigurimit të pronës të kërkuar nga bankat e nivelit të dytë për sigurimin e përmbushjes së detyrimeve që rrjedhin nga Kreditë? A do mbulojë kjo policë edhe pretendimet nga banka në rastin e një ngjarje të tillë sigurimi? Nëse po



cila do të jetë procedura? Nëse jo si do veprohet me mbivendosjen e kostove dhe të mbulimit përkatës?

Neni 5, pika 1. Koment: Po kur prona shitet si bëhet kalimi i policës së sigurimit me përfitues pronarin e ri, pasi periudha është 1 vit? A është e transferueshme polica e sigurimit të banesës tek pronari i ri?

Neni 5, pika 4. Koment: A e njej ligji sigurimin e pronës nga tërmetet nga një kompani private e sigurimit? Nëse sigurimi i pronës ndaj tërmetit (i.e. zjarrit etj) mund të jetë bërë për qëllime të vendosjes kolateral në bankë, me vullnetin e lirë të pronarit po në një kompani private, apo mund të jetë siguruar nga ndërtuesi për një afat 10 vjeçar. A bën përjashtim nga detyrimi për sigurim nëse posedohet një policë nga rastet e mësipërme por jo vetëm?

Neni 6, pika 2/c. Koment: “*sendet brenda banesës së objektit të siguruar*” nuk duhet të jenë të përjashtuara. Bëhet fjalë për banesa dhe banesat kanë së paku elektroshtëpiaket dhe mobilimin të cilat nuk mund të mos përfshihen.

Neni 6, pika 2/d. “*...shpenzimet në lidhje me heqjen dhe zhvendosjen e mbeturinave...*”
Koment: Kjo është pjesë e procesit të riparimeve apo rindërtimeve?

Neni 7, pika 1 dhe 2. Koment: Ligji duhet të vendosë disa kufij në lidhje me metodën e përlllogaritjes së vlerave/shumave të siguruara. Në parim nuk ka nevojë të ketë një VKM për përcaktimin e këtyre vlerave, kur limiti maksimal i dëmshpërblimit duhet të jetë vetë vlera e sendit të siguruar (banesës)

Pjesë shumë e rëndësishme për tu sqaruar në këtë projektligji është: Si do të përcaktohet shuma maksimale e sigurimit? Do të merret si referencë vetëm kosto e rindërtimit apo edhe vlera e tregut e objektit që sigurohet? Do të ketë zgjedhje paguesi kundrejt një primi më të lartë që të sigurojë pronën për vlerë tregu? Në përcaktimin e shumës së sigurimit duhet të merret parasysh edhe ndikimi që do të ketë tek kredimarrësit. Nëse shuma e sigurimit nuk përputhet me vlerën e tregut të pronës kredimarrësi duhet të bëjë sigurim shtesë për të garantuar pronën e vendosur si kolateral për kredinë e marrë.

Gjithsesi ndikimi tek kredimarrësit nuk kufizohet vetëm me shumën por shtrihet edhe tek rreziqet që mbulohen me sigurim. Kredimarrësit duhet ta sigurojnë pronën edhe nga rreziqe të tjera përveç tërmetit.

Neni 9, pika 1. Koment: Edhe njëherë këtu konstatohen një sërë çështjesh të paqarta:

Cilët do të jenë agjentët e shitjes? Do të jenë agjentë të liçensuar nga AMF për shitje sigurimesh. Apo do të jenë ndërmjetës financiar të liçensuar nga BSH. Çfarë kriteresh profesionale duhet të përmbushin?

Cila do të jetë procedura e shitjes, dokumentacioni etj info të nevojshme për gjenerimin e policës së sigurimit?

Neni 9, pika 2/c. Koment: Nëse këto përcaktohen që në ligj, pse duhet të përfshihen edhe në policë. Thjesht informues për siguriesin apo mund të ketë ndryshime (pra sigurim për elemente shtesë, përtej çfarë parashikon ky ligj)?



Neni 9, pika 2/e Koment: Sugjerojmë të shtohet edhe “*Si edhe limitet e mbulimit në agregat dhe per cdo ngjarje*”

Neni 9, pika 5. Koment: Në parim këto kushte apo kriteret kryesore të tyre të përmendura në këtë pikë duhet të ishin bashkëngjitur këtij ligji.

Neni 10. Koment: Po nëse palët nuk janë dakord me vlerësimin e ekspertit? Mund të caktojnë ekspertë të tjerë?

Neni 10, pika 1. Koment: Edhe njëherë konstatohet që duhen sqaruar: Çfarë është Fondi dhe ku është i perkufizuar ai? Cili është roli i Fondit në funksion të këtij projektligji? A luan Fondi rolin e Siguruesit? Nëse po, mbi bazën e kujt ligji? A është subjekt i liçensuar për këtë qëllim? Çfarë kompetencash ka?

Neni 11, pika 2. Koment: Duhet specifikuar nëse ka apo jo afat kohor për të paraqitur kërkesën pas ndodhjes së ngjarjes së sigurimit.

Neni 11, pika 3. Koment: Rregullat dhe procedurat për pagesën e dëmeve duhet të jenë të përcaktuara edhe në kushtet e Policës së Sigurimit. Në çdo rast mendojmë që ato gjithashtu duhet të publikohen në të njëjtën kohë me ligjin.

Neni 11, pika 4. Koment: Afati i kompensimit deri në 9 muaj është shumë i gjatë sidomos nëse marrim parasysh që banesa mund të ketë dalë jashtë përdorimit. Kush e mbulon koston e qerasë për këtë periudhë? Nëse një qytetari i është prishur shtëpia ku do qëndrojë 9 muaj sa të mbarojnë procedurat burokratike të institucionit? Afati ose duhet të afrohet deri në 3 muaj ose ligji duhet të parashikojë kompensim për strehim për qytetarët që kanë pësuar dëme dhe banesa cilësohet e pabanueshme. Sugjerojmë që të rishihet dhe të vendoset një skemë në varësi të shumës dhe specifikave të ngjarjes së sigurimit por për këtë duhet një metodologji vlerësuese paraprake.

Neni 11, pika 5. Koment: Agjent i autorizuar nga kush? Çfarë kriteresh duhet të plotesojë agjenti? Sot në tregun financiar operojnë banka dhe institucione të liçensuara për ndërmjetësim pagesash. Përse specifikohet në projektligj një agjent? Cili është raporti mes këtij agjenti, siguruesit dhe të siguruarit? Ku shprehet ky raport?

Neni 11, pika 6. Koment: Pse duhet të përcaktohet në ligj vullneti i lirë i qytetarit për të falur, dhuruar dëmshpërblimin e përfutur? Cila është logjika e pikës, pasi po flasim për kompensim dëmi nga tërmeti dhe jo të ardhura të përfutura nga dhurimet apo trashëgimia etj

Po në rastet e ndërtesave me bashkëpronësi si do të veprohet? Nëse një pjesë e bashkëpronarëve largohen dhe një pjesë duan të rindërtojnë? Rindërtimi në këtë rast mund të jetë i pamundur pasi jo të gjithë duan të rindërtojnë. Me vlerën maksimale të dëmshpërblimit mund të blejnë një pronë të re të ngjashme me të dëmtuarën dhe pak a shumë në të njëjtën zonë në të cilën banonin.

Neni 12, pika 5. Koment: Në rast se FKT nuk jep përgjigje brenda afatit 15 ditor, atëherë përsëri subjekti mund të ankohet në Gjykatën civile. Duhet që të parashikohet dhe kjo pikë.

Kreu IV Fondi Kombëtar nga Tërmetet: Koment: E gjithë përmbajtja e këtij kreu është e papranueshme dhe e paprecedentë. Sigurimi i pronës me detyrim sipas ligjit në



Fondin Kombëtar të Tërmetit, cënon konkurrencën e lirë në treg me subjektet private që e ofrojnë këtë shërbim.

Fondi Kombëtar nga Tërmetet duhet t'i nështrohet legjislacionit shqiptar në fuqi në lidhje me veprimtaritë e sigurimit. Në një rast të tillë konstatojmë gjithashtu se jemi përballë një konflikti interesi, që një person juridik i kontrolluar nga shteti të ushtrojë një veprimtari të rregulluar nga legjislacioni në fjalë. Ndërhyrja e shtetit në parimet e konkurrencës është e papranueshme.

Gjithashtu, roli i Fondit dhe struktura e Fondit Kombëtar për Tërmetet (në vijim Fondi) nuk del qartë në projektakt dhe kjo është një nga pikat më të rëndësishme. Nga projektligji nuk parashikohet qartë nëse Shteti do të jetë aksionar i vetëm i këtij Fondi. Si do të auditohet ky Fond? Diskrecion i plotë në përbërjen e Bordit (Organi mbikqyrës i Fondit Kombëtar për Tërmetet) i është lënë Ministrsit përgjegjës për Financat. Ne sugjerojmë që përbërja e Bordit të miratohet edhe nga Këshilli i Ministrave.

Neni 14, pika 2/f. Koment: Fondi Kombëtar i Tërmetit financon fondin e rindërtimit, ndërkohë nga ana tjetër shteti financon FKT. A kemi një dublikim të kompetencave në qëllimin e ekzistencës së këtyre institucioneve? Krijimi i kaq shume strukturave rëndon qartësisht kostot në buxhetin e shtetit. Kjo është një klauzolë e paqartë, që krijon më tepër pasiguri në administrimin e procesit të dëmshpërblimit.

Neni 25. Operatori teknik Ndërkombëtar. Koment: Pra do të jetë një subjekt privat që doë kryejë shërbimet e sigurimit? Nuk është e qartë dhe nuk ka një ndarje të pastër të kompetencave mes shtetit dhe operatorit. Përgjegjësitë e njërit dhe tjetrit.

Për më tepër këto funksione duhet të kryhen nga subjekte të licensuar nga autoritetet lokale (BSH, AMF) dhe nuk mund të ketë deformim konkurrence duke përcaktuar vetëm një të tillë.

Neni 25, pika 2. Koment: Njëpërmjet cilit mekanizëm dhe cilave kriteret do të realizohen këto bashkëpunime të Fondit?

Neni 27. Koment: Këtu ka përsëri paqartësi. Nëse bëhet fjalë për shitje police apo për arkëtim pagese (primi i sigurimit) shitjen e policës së sigurimit duhet ta bëjë një subjekt i licensuar nga AMF për ndërmjetësim në sigurime ose një kompani sigurimi në përputhje me ligjin aktual për sigurimet dhe nuk duhet shkaktuar deformim të konkurrencës duke autorizuar vetëm një subjekt.

Gjithsesi duke qenë se policat do të gjenerohen nga e-Albania, në këtë rast nuk kemi më të bëjmë me një shitje police por vetëm me arkëtim pagese (prim sigurimi). Arkëtimi i pagesës mund të kryhet nga cdo subjekt i licensuar nga BSH në Republikën e Shqipërisë dhe si më lartë nuk ka përse të autorizohet vetëm një i tillë (i licensuar apo jo nga BSH) duke shkaktuar deformim të konkurrencës.

Neni 27, pika 1. Koment: Po Agjenti cila palë është? Ku ndryshon nga Operatori? Cilat janë kompetencat dhe kriteret e emërimit?

Neni 27, pika 3. Koment: Nëse agjenti emërohet nga Këshilli Ministrave, pse kontrata duhet të lidhet me FKT? Pse është e nevojshme në thelb lidhja e një kontrate? Cilat do të jenë kushtet e një kontrate të tillë?



AMERICAN CHAMBER OF COMMERCE
DHOMA AMERIKANE E TREGTISË

Neni 28, pika 3. "Përzgjedhja e risiguruesit/risiguruesve përjashtohet nga rregullat e prokurimit publik" **Koment:** Për cilën arsye ky përjashtim?

Neni 31, pika 3. Koment: Ku konsiston kjo mbikqyrje? A implikon kjo mbikqyrje lidhje varësie mes dy institucioneve? Çfarë ndodh nëse AMF vëren ndonjë shkelje apo parregullsi? Ku është parashikuar të rregullohen këto marrëdhënie.

Neni 33, pika 1. Koment: Të tilla masa shtrënguese janë jo proporcionale kundrejt shkeljes së kryer dhe detyrimin të organeve publike për të ofruar shërbime publike ndaj qytetarit.

Me respekt,

Neritan Mullaj

Drejtor Ekzekutiv

